



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, Nenit 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.6 dhe 2.16 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, (Ligji Nr. 03/L-185);
- Rregullën për vendosjen e Çmimeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për Çmimet e OSSH-së), 2011;
- Parimet e përcaktimit të ngarkesave për shpërndarje nxjerrë nga ZRRE-ja me 18.07.2012, dhe
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (KEK Sh.A) të datës 25.02.2013 për shqyrtim dhe aprovim të dokumentit “Metodologjia e përcaktimit të ngarkesave për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes”.

në seancën e mbajtur me datë 02 maj 2013, nxori këtë:

VENDIM

I. APROVOHET “Metodologjia e Ngarkesave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes”

ARSYETIM

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 25.02.2013 ka pranuar kërkesën nga KEK Sh.A (Operatori i Sistemit të Shpërndarjes) për aprovim të dokumentit “Metodologjia e ngarkesave për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes”;
 - ZRRE ka qenë e kyçur gjatë tërë kohës së hartimit të dokumentit dhe ka dhënë komentet e veta gjatë takimeve drejtpërdrejt, por dhe në formë të shkruar;
 - Me 24 gusht 2012 Zyra e Rregullatorit për Energji i ka ofruar KEK-ut Komentet e veta në Metodologjinë e Përcaktimit të Ngarkesave të OSSH-së;
 - Me 28 shtator KEK Sh.A ka derguar përgjigjet e komenteve të ZRRE-së rreth Metodologjisë së Ngarkesave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes;
- II.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe;
- III.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të KEK-ut;



Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të KEK-ut, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar